



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 08.05.2023

Nr: 82

Ora: 13:00

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 22, DATË 06.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 08.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj zj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; zj. Zerina Bruçi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës; z. Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë; zj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zj. Risena Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.



BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 22 regj., datë 06.05.2023. Në mbledhjen e datës 08.05.2023, ora 13:00, pas relatimit të z. Koli Bele, u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 22, datë 06.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 10.05.2023, ora 11:30.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar